



EUROPEAN UNION

Njësia Qendrore e Rregullatorit Zyra e Rregullatorit për Energji



United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

Udhëzim i Përkohshëm Nr. 01/2004 Mbi Parimet e Kalkulimit të Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qëndrore në Kosovë për Sezonën e Ngrohjes 2004/2005

KAPITULLI 1 Dispozitat e Përgjithëshme

Neni 1

Në përputhje me UNMIK/REG/2000/49 Mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale Publike, Njësia Qendrore e Rregullatorit/Zyra e Rregullatorit për Energji lëshojnë udhëzimin e përkohshëm për Parimet e Kalkulimit të Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qëndrore në Kosovë (“Udhëzimi”).

Neni 2. Qëllimi

- 2.1 Ky Udhëzim përcakton parimet për kalkulim dhe aprovim të çmimeve dhe tarifave të ngrohjes në tregun e organizuar të ngrohjes qendrore për sezonën e ngrohjes 2004/2005.
- 2.2 Termet e përdorura në këtë udhëzim do të kenë kuptimin e njejtë ashtu siç e kanë në Ligjin e Rregullatorit për Energji Nr. 2004/9, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/20, e datës 30 Qershor, 2004.

KAPITULLI 2 Procedurat për dorëzimin dhe aprovim të çmimeve dhe tarifave

Neni 3 Fillimi i procedurës

- 3.1 Ndërmarrja e ngrohjes dorëzon në Zyren e Rregullatorit të Energjisë një aplikacion me shkrim për aprovim të çmimeve dhe tarifave të ngrohjes për sezonën e ngrohjes 2004/2005.

Neni 4 Verifikimi i Aplikimit

- 4.1 Kur një aplikacion është në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të ekzaminoj të gjitha të dhënat e rënditura në aplikacion, si dhe në dokumentet e bashkangjitura.
- 4.2 Zyra e Rregullatorit për Energji mund të vertetoj me iniciativën e vet të dhënat dhe rrethanat e deklaruara, dhe mund të kontaktoj ndërmarrjet e ngrohjes dhe të kërkoj nga to dokumente dhe informata shtesë. Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore duhet të jenë të gatshme të ofrojnë informata dhe të dhëna Zyres së Rregullatorit për Energji.

- 4.3 Ndërmarrja e ngrohjes është e obliguar që ti ofroj tërë ndihmën e nevojshme Zyres së Rregullatorit për Energji
- 4.4 Kur Ndërmarrja e Energjisë dorzon për herë të parë në Zyren e Rregullatorit për Energji çmimet për aprovim, Zyra e Rregullatorit për Energji do të marrë parasysh standardet ekzistuese të investimeve si dhe nivelin aktual të vlerave të interesit.

Neni 5 Ekzaminimi formal

- 5.1 Brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pas pranimit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të ekzaminoj aplikacionin e dorëzuar, dokumentet e bashkangjitur të kërkuara.
- 5.2 Nëse aplikacioni, dokumentet e bashkangjitur të kërkuara nuk përputhen me dispozitat e Udhëzimit, ose nëse të gjitha dokumentet e kërkuara nuk janë të bashkangjitura, Zyra e Rregullatorit për Energji do të njoftoj parashtruesin e kërkesës. Njoftimi me shkrim do të ftoj parashtruesin e kërkesës që të korrigjoj aplikacionin e tij brenda shtatë (7) ditëve kalendarike që nga data e njohtimit.
- 5.3 Në rast kur parashtruesi i aplikacionit dështon që të përmirsoj mospërshtatshmërinë e aplikacionit të tij, ose dokumenteve të kërkuar të bashkangjitur brenda perjudhës së përcaktuar në paragrafin 2, Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të refuzoj aplikacionin dhe të njoftoj me shkrim parashtruesin e aplikacionit brenda shtatë (7) ditëve kalendarike që nga data e përcaktuar në Nenin 5.2.
- 5.4 Në rastin kur Zyra e Rregullatorit për Energji e refuzon aplikacionin ashtu siç përcaktohet në Nenin 5.3, Zyra e Rregullatorit për Energji do të vë gjobat në përputhje me Nenin 57 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë gjersa të përmbushen këkesat siq përcaktohet në Nenin 5.2.

Neni 6 Propozimi i strukturës tarifore dhe çmimeve

- 6.1 Në aplikacionin e tyre, drejtuar Zyres së Rregullatorit për Energji para sezonës së ngrohjes, e cila zyrtarisht fillon me 15 tetor 2004 dhe mbaron me 15 prill 2005, ndërmarrjet e ngrohjes do të përfshijnë propozimet e tyre për strukturën e tarifës dhe për çmimet.
- 6.2 Propozimi do të përfshijë:
- a) Strukturën tarifore dhe çmimin për ngrohjen e dërguar tek konsumatori i fundit;
 - b) Tarifën për kyçje në rrjetin e distribuimit të ngrohjes.

Neni 7 Përmbajtja e aplikacionit

- 7.1 Aplikacioni për aprovimin e çmimeve dhe të tarifave të ngrohjes duhet që të specifikoj:
- a) emrin e parashtruesit të aplikacionit (aplikuesit), zyren e regjistruar, adresën e zyrës kryesore dhe numrin e regjstrimit të taksave të parashtruesit të kërkesës (aplikuesit);
 - b) propozimin dhe bazat për strukturën tarifore dhe çmimet dhe perjudhën e validitetit të tyre;
 - c) nënshkrimin e personit që e përfaqëson parashtruesin e aplikacionit (aplikuesin).
- 7.2. Parashtruesi i aplikacionit (aplikuesi) do të dorëzoj në Zyren e Rregullatorit të Energjisë në formë të dokumentit të bashkangjitur, dokumentet në vazhdim:
- a) gjendjen financiare vjetore të vitit të mëparshëm me dokumentin e bashkangjitur
 - i. raportin e auditorit nëse gjendja vjetore financiare e parashtruesit të aplikacionit (aplikuesit) i është nënshtruar auditimit të pamvarur financiar;

- b) përshkrim të detalizuar të burimeve të fondeve për aktivitetet e energjisë dhe evidencë të disponueshmërisë së resurseve të tilla;
 - c) kalkulime të detalizuara, evidencë dhe baza për kalkulim të secilit element të ndarë të çmimeve dhe tarifave në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi;
 - d) informata në lidhje me të hyrat e vlerësuara nga shitja e ngrohjes tek konsumatorët e fundit, totalin e shpenzimeve të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit të ngrohjes, totali i kapacitetit të ngrohjes së kontraktuar dhe totali i prodhimit të ngrohjes në MWh
 - e) listën e të gjitha dokumenteve të dorëzuara.
- 7.3. Nëse parashtruesi i kërkesës (aplikuesi) ka për qëllim që të implementoj një projekt afatgjatë investues, përveç dokumenteve të specifikuara në Nenin 7.2, duhet të dorzoj:
- a) një model financiar për perjudhën e projektit;
 - b) një përshkrim të parametrave të rëndësishme të modelit financiar;
 - c) marrëveshjet e nënshkruara të cilat e udhëheqin implementimin e projektit dhe parimet e përcaktimit të çmimeve.
 - d) Arsyetim të plotë të arsyeve për një investim të tillë.

Neni 8 Shqyrtimi i çmimeve dhe tarifave

- 8.1 Ndërmarrjet e ngrohjes duhet të raportojnë në propozimet e tyre për shpenzimet që aktualisht ata i kanë shkaktuar në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe me standardet e aplikueshme të kontabilitetit në Kosovë.
- 8.2 Gjatë perjudhes rregullative (sezoni i ngrohjes 2004/2005) ndërmarrjet e ngrohjes kanë të drejtë që të dorzojnë propozimet Zyres së Rregullatorit për Energji për ndryshim të çmimeve fillestare të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në çoftë për shkak të ndryshimeve në ndërmarrje ose për shkak të ndryshimit të ndonjë legjislacioni të aplikueshëm në Kosovë.
- 8.3 Duke ju referuar Nenit 8.2. ndërmarrjet e ngrohjes do të bashkangjisin propozimit dokumentet që janë të nevojshme për arsyetim të duhur për ndryshimin e propozuar.
- 8.4 Zyra e Rregullatorit për Energji do të shqyrtoj kërkesat së bashku me arsyetimin dhe ndonjë dokument të bashkangjitur dhe të marr vendim në përputhje me Nenin 4 të këtij Udhëzimi.

KAPITULLI 3 Procedura për kalkulimin e tarifës

Neni 9 Parimet për kalkulimin e tarifave

- 9.1 Tarifa që është lëndë e këtij Udhëzimi do të aplikohet për faturimin e konsumatorëve pa matës. Tarifa përfshinë konsumin e përafërt për metër katror, që quhet tarifa normative. Nëse që nga hyrja e këtij udhëzimi në fuqi, matja e ngrohjes në pikat e furnizimit ende nuk është implementuar, konsumatorët e kyçur në këto pika të furnizimit do të faturohen sipas tarifës normative për vitin e faturimit dhe në proporcion me totalin e sipërfaqës së objektit të konsumatorit.
- 9.2 Propozimi për tarifa do të bazohet sipas kalkulimit të tre shpenzimeve njësi:
- a) shpenzimet fikse të prodhimit të ngrohjes, distribuimit dhe furnizimit;
 - b) shpenzimet variabile të prodhimit të energjisë, distribuimit dhe furnizimit;
 - c) tarifën për kyçje të konsumatorëve të ri (Neni 13, Paragrafi 4)

Neni 10 Ndarja e konsumatorëve në grupet tarifore

- 10.1 Ndarja e konsumatorëve në disa grupe tarifore do të bëhet vetëm nëse arsyetohet me ndryshimin e shpenzimeve të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore për dërgim të ngrohjes tek ata, sipas kritereve në vazhdim:
- a) burimet e prodhimit të ngrohjes që ushqejnë rrjetin e ngrohjes qendrore;
 - b) rrjeti i ngrohjes qendrore që shpërndan ngrohjen;
 - c) vendi ku dërgohet ngrohja dhe sfera e duhur e furnizimit;
 - d) kërkesat e konsumatorëve në lidhje me furnizimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të ngrohjes;

Neni 11 Bazat për identifikim të shpenzimeve të arsyetuara

- 11.1 Shpenzimet e arsyetuara duke qenë bazë për kalkulim të shpenzimeve dhe çmimeve njësi do të jenë të bazuara në:
- a) shpenzimet vjetore të parashikuara, shpenzimet e përbëra nga mirëmbajtja dhe shpenzimet financiare;
 - b) shpenzimet vjetore të parashikuara të rivendosjes së paisjeve dhe zgjerimit;
 - c) shpenzimet vjetore të parashikuara që janë të ndërlidhura me mbrojtjen e ambijentit;
 - d) shpenzimet vjetore të përbashkëta (menaxhimi, administrimi etj.).
 - e) taksat / tatimet vjetore
- 11.2 Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore kanë të drejtë të propozojnë Zyrës së Rregullatorit për Energji që në kalkulimin e çmimit njësi të përfshijnë edhe një profit të arsyeshëm e shprehur në përqindje të fitimit neto; Është në lirinë e veprimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji të aprovoj, modifikoj ose korrigjoj profitin e propozuar.

Neni 12 Llojet e shpenzimeve të arsyetuara

- 12.1 Ndërmarrjet e ngrohjes janë të lejuara që të mbulojnë të gjitha shpenzimet e arsyetuara duke përfshirë:
- a) shpenzimet e mirëmbajtjes së karburanteve dhe rezervave të karburanteve, pagat dhe të ardhurat;
 - b) shpenzimet e menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes, rivendosjes dhe ndërtimit të objekteve të energjisë, shpenzimet e ndërprerjes ose përfundimit të punëve të objekteve dhe paisjeve të energjisë dhe objekteve për ruajtjen e rezervave të karburanteve;
 - c) shpenzimet e mirëmbajtjes të rezervave dhe të kapaciteteve të rregulluara, që kërkohen për të siguruar furnizim të sigurt për konsumatorët;
 - d) shpenzimet e amortizimit të kapitaleve;
 - e) shpenzimet e obligimeve të shërbimeve publike dhe obligimeve të tjera të ndërmarrjeve të ngrohjes.
- 12.2 Ndërmarrjet e ngrohjes janë të obliguara që të tregojnë përmirësimin e efikasitetit operativ dhe financiar.

Neni 13 Detalet për kalkulimin e çmimit njësi

- 13.1 Totali i çmimit njësi përmban shumën e çmimit njësi të kapacitetit të ngrohjes dhe të çmimit njësi të ngrohjes së dërguar, e kalkuluar sipas formulës:

$$U_p = U_c + U_h$$

ku:

U_p	Çmimi total njësi i ngrohjes	€/ m ² vit
U_c	Çmimi njësi i kapacitetit të ngrohjes	€/ m ² vit
U_h	Çmimi njësi i ngrohjes së dërguar	€/ m ² vit

- 13.2 Çmimi njësi i kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes (pagesa për kapacitetin) do të kalkulohet bazuar në formulën:

$$U_c = K_f : S$$

ku:

U_c	Çmimi njësi i kapacitetit të ngrohjes	€/ m ² vit
K_f	Totali i shpenzimeve vjetore fikse të parashikuara	€/ vit
S	Totali i sipërfaqes për ngrohje (baza e të dhënave të konsumatorëve)	m ²

- 13.3 Çmimi njësi i ngrohjes së dërguar (pagesa për energjinë e dërguar) do të kalkulohet bazuar në formulën:

$$U_h = K_v : S$$

ku:

U_h	Çmimi njësi i ngrohjes	€/ m ² vit
K_v	Totali i shpenzimeve vjetore variable të parashikuara	€/ vit
S	Totali i sipërfaqes për ngrohje (baza e të dhënave të konsumatorëve)	m ²

- 13.4 Kalkulimi i tarifës për kyçje për kyçjet e reja do të bëhet sipas Udhëzimit të veçant Nr. 02 / 2004 për Kushtet dhe Procedura për Kyçjet e Reja në Rrjetin e Distribuimit të Ngrhjes Qëndrore.

Neni 14 Çmimet për Konsumatorë

- 14.1 Kontrata në mes ndërmarrjeve të ngrohjes dhe konsumatorëve të kyçur në rrjetin e distribuimit të ngrohjes do të përfshijnë çmimet e ngrohjes për konsumatorët.
- 14.2. Për konsumatorët, çmimi do të bazohet sipas tarifës normative të përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë sipas propozimeve të ndërmarrjeve të ngrohjes, bazuar në:
- Çmimi total për ngrohje deri te pika furnizuese e konsumatorit;
 - Çmimi (tarifa) për kyçje të re në rrjetin e distribuimit.

- 14.3 Ndërmarrjet e ngrohjes do të faturojnë konsumin e vlerësuar përfaqësisht të konsumatorit duke aplikuar çmimin njësi të përcaktuar në tarifë për perjudhën rregullative.

Neni 15 Propozimi për ndryshim të tarifave

- 15.1 Gjatë perjudhës rregullative ndërmarrjet e ngrohjes mund të paraqesin tek Zyra e Rregullatorit për Energji propozimet për ndryshimet e arsyetuara në tarifën e tyre të aprovuar në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë Udhëzim.
- 15.2 Këto ndryshime mund të arsyetohen me ndryshimet e legjislacionit, ndryshime të rëndësishme të çmimeve të karburanteve dhe shkaqeve të tjera që janë jashtë kontrollit të ndërmarrjeve të ngrohjes.
- 15.3 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të aprovoj ose refuzoj propozimin në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim.

KAPITULLI 4 – Dispozitat Përfundimtare

Neni 16 Shqyrtimet

- 16.1 Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të bëjë shqyrtime të rregullta, për qëllim të:
- a) evaluimit të informatave financiare të raportuara dhe vlerësuara të dorzuara nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore;
 - b) aprovimit të llojeve të shpenzimeve aktuale gjatë perjudhës rregullative në përputhje me legjislacionin ekzistues për financa dhe kontabilitet;
 - c) përcaktimit të të hyrave për periudhën rregullative;
 - d) aprovimin e çmimeve fillestare të llogaritura për secilën ndërmarrje të ngrohjes qendrore të licensuar.

Neni 17 Gjuha dhe hyrja në fuqi

- 17.1. Aplikacionet dhe dokumentet e bashkangjitura të përcaktuara me këtë Udhëzim duhet të kompletohen në njëerën nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Aplikuesi duhet të përkthejë dokumentet që nuk janë në gjuhën shqipe, serbishte, ose anglishte.
- 17.3. Aplikacionet duhet të regjistrohen në Regjistrat e ZRRE-së dhe të azhurohen rregullisht.
- 17.4. Ky Udhëzim do të jetë i aplikueshëm menjëher pasi të jetë nënshkruar.

Drejtori i Njësisë Qendrore të Rregullatorit

Bjorn Hauksson

Data: 27 Shtator, 2004